Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit

Shtator 2026

Prishtinë, 13.11.2026 - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin statistikor me të dhëna mujore për Transportin dhe Telekomunikimin për muajin shtator 2026. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna mujore për transportin ajror, transportin hekurudhor dhe telekomunikimin.

Qëllimi i publikimit është të paraqesë tendencat e zhvillimit të këtij sektori në ekonominë e vendit. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe do të ofrojë informacion të dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund t'i dërgoni në adresën zyrtare : infoask@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit te Statistikave Ekonomike
Bekim Bojku - Udhëheqës i Divizionit Statistikave Ekonomike
Qendresa Shala Sopaj - Zyrtare e lartë për Statistika të Ndërmarrjeve
Shqipe Zubaku - Zyrtare për Statistika të Ndërmarrjeve

Nëntor, 2026

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së
z. Avni Kastrati

Për t'u konsultuar me publikime të tjera, vizitoni faqen e ASK: http://ask.rks-gov.net

Shkurtesat

ANP "Adem Jashari" / LIMAK – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

TRAINKOS, Sh.A. – Hekurudhat e Kosovës

VALA - Telefonia Fikse dhe Mobile

IPKO- Telefonia Fikse dhe Mobile

MTS – Telefonia Fikse dhe Mobile

tkm – ton-kilometër

Prepaid – Përdorues me parapagim

Postpaid – Përdorues me kontratë

Simbolet

- Nuk aplikohet

% Përqindje

+ / − Rritje / Rënie krahasuar me periudhën referuese

p Të dhëna preliminare

1. Transporti Ajror

Në muajin shtator 2026 Numri i fluturimeve të realizuara ishte 2,548 apo 6.5 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 393,360 apo 4.9 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Shtator 2025).

Tab.1: Numri i fluturimeve dhe udhëtarëve në % Shtator 2026 / Shtator 2025

Përshkrimi	Shtator 2025	Shtator 2026	Ndryshimi në përqindje
1.Numri i fluturimeve të realizuara	2,392	2,548	6.5
2.Numri i udhëtareve në total (a+b)	374,982	393,360	4.9
a.Numri i udhëtareve ne ardhje	165,570	171,168	3.4
b.Numri i udhëtareve ne shkuarje	209,412	222,192	6.1

Fig.1: Numri i fluturimeve në Shtator 2026 krahasuar me muajin Shtator të vitit 2025





Fig.2: Numri i udhëtarëve në Shtator 2026 krahasuar me muajin Shtator të vitit 2025




2.Transporti Hekurudhor

Në muajin shtator 2026 numri i udhëtarëve në transportin hekurudhor ishte 7 167 apo (-12,8 %) më pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2025. Ndërsa mallra të transportuara përmes transportit hekurudhor nuk kishte në këtë muaj.

Tab.2: Transporti hekurudhor në % Shtator 2026 /Shtator 2025

Përshkrimi	Shtator 2025	Shtator 2026	Ndryshimi në përqindje
Numri i udhëtarëve	8,218	7,167	-12.8
Sasia e mallrave të transportuar në neto tonë	-	-	0
Sasia e mallrave të transportuar në neto tonë/km	-	-	0

Fig.3: Numri i udhëtarëve në transportin hekurudhor në Shtator 2026 krahasuar me Shtator të vitit 2025



3.Telekomunikimi


3.1. Telefonia Fikse

Në muajin shtator 2026, numri i përdoruesve në rrjetin e telefonisë fikse ishte 72,905 me një rritje prej 7,1 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, trafiku i realizuar (në minuta) ishte 1,722,676 me një rënje prej (-12,2 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tab.3: Përdoruesit dhe trafiku i realizuar në telefoninë fikse në % Shtator 2026 /Shtator 2025

Përshkrimi	Shtator 2025	Shtator 2026	Ndryshimi në përqindje
Numri i përdoruesve te rrjetit telefonik fiks	68,091	72,905	7.1
Trafiku i realizuar (në minuta)	1,962,842	1,722,676	-12.2

Fig.4: Numri i përdoruesve te rrjetit telefonik fikse dhe trafiku i realizuar (në minuta) në Shtator 2026 krahasuar me Shtator të vitit 2025



3.2. Telefonia Mobile

Në muajin shtator 2026 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1,646,103 apo (-2,19 %) më pak se në periudhën e njëjte të vitit të kaluar. Ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 325,120 mije apo 1,18 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tab.4: Përdoruesit e telefonisë mobile në % **Shtator 2026 /Shtator 2025**

Përshkrimi	Shtator 2025	Shtator 2026	Ndryshimi në përqindje
Përdoruesit me parapagim (Prepaid)	1,682,992	1,646,103	-2.19
Përdoruesit me kontratë (Postpaid)	321,338	325,120	1.18

Fig.7: Përdoruesit me parapagim (Prepaid)





Fig.8: Përdoruesit me kontratë (Postpaid)



Shpjegime metodologjike dhe Përkufizimet

Burimet

Statistikat e transportit dhe telekomunikimit bazohen kryesisht në burime administrativ. Burimet e të dhënave përfshijnë:

ANP- Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës -Adem Jashari (LIMAK);

TRAINKOS – Hekurudhat e Kosovës;

ARKEP Sh.P.K– Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

VALA- Telefonia fikse dhe mobile;

IPKO- Kompania telekomunikimit;

MTS -Telefonia fikse dhe mobile.

Mbulimi

Të dhënat Statistikore me bazë mujore për periudhën nga viti 2022 deri në Shtator 2026 përfshijnë Statistikat e transportit ajror, transportit hekurudhor dhe telekomunikimit.

Publikimi i të dhënave

Të dhënat mujore publikohen 45 ditë pas përfundimit të muajit referues dhe janë të dhëna preliminare.

Të dhënat e publikuara të statistikave të Transportit dhe Telekomunikimit janë:

Në baza mujore : Statistikat e transportit ajror, Statistikat e transportit hekurudhor dhe Telekomunikimit.

Përkufizimet

Ton-kilometër (tkm) -Njësia e matjes së transportit të mallrave që përfaqëson transportin e një ton të mallrave mbi një distancë prej një kilometri.

Distanca që duhet mbuluar është distanca që aktualisht është udhëtuar në rrjetin e shqyrtuar. Për të shmangur numërimin e dyfishtë, secili vend duhet të llogarisë vetëm t km që kryhet në territorin e saj.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
  Rr. ”Zenel Salihu”, nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni**: Tel: +381 (0) 38 200 11 573: (0) 38 200 11 574
- Drejtori Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 11 500
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** **infoask@rks-gov.net**
- **Ueb-faqe:** **http://ask.rks-gov.net**

- © Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi .